



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 153, Datë 17/07/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 54, datë 24.04.2018, e Znj. N. H., ku pretendohet diskriminim për shkak të “bindjes politike” dhe “vendlindjes”, nga ana e Z. E. A., Drejtor i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Znj. D. R., ish-Drejtoreshë e Drejtorisë Ekonomike pranë FSDKSH-së dhe Znj. O. B., Drejtoreshë e Marrëdhënieve me Publikun, pranë FSDKSH-së.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se Znj. N. H., e lindur në Dragobi, Tropojë, në datën 26.03.1959, banuese në Tiranë, me profesion mësuese, ka punuar pranë Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, prej 8 (tetë) vitesh. Fillimisht, ka punuar në pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit të Zbatimit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare e në vijim në pozicionin e specialistes së Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, pranë FSDKSH-së.

Ankuesja fakton se në datën 19.03.2018, ka marrë në dorëzim shkresën nr. 1391, datë 19.03.2018, nëpërmjet së cilës është njoftuar nga punëdhënësi për zhvillimin e një takimi për të diskutuar, lidhur me vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës. Në datën 23.03.2018, është realizuar takimi ndërmjet ankueses dhe përfaqësuesve të punëdhënësit pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, ku ankuesja është bërë me dije mbi reformën që po zbatohet pranë FSDKSH, procesin e ristrukturimit të këtij institucioni dhe suprimimin e vendit të saj të punës. Ankuesja shprehet se nuk ka qënë dakord me sa më sipër, por përgjigja e vetme e ardhur nga punëdhënësi, ka qënë Urdhëri nr. 1391/3, datë 03.04.2018 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”.

Duke qënë se objeksionet e ankueses, të cilat rezultojnë të pasqyruara në procesverbalin e takimit të realizuar në datën 23.03.2018, nuk janë marrë parasysh, ajo i është drejtuar titullarit të

institucionit me Memon e datës 12.04.2018, ku janë parashtruar edhe një herë arsyet, për të cilat ankuesja nuk bie dakord me vendimin e tij. Znj. N. H. thekson faktin se asnjëherë nuk është njoftuar zyrtarisht apo me e-mail dhe nuk ka patur dijeni mbi procesin e ristrukturimit të institucionit, ku ajo punonte. Në asnjë moment nuk i është vënë në dispozicion Vendimi nr. 14, datë 02.02.2018, i Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH-së “Për miratimin e strukturës organizative, strukturës së brendshme dhe të rregullores për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e punës së FSDKSH”. Gjithashtu, ankuesja pretendon se ka një CV tepër të pasur me kualifikime dhe trajnime dhe ndaj saj nuk është marrë ndonjëherë masë disiplinore, por pavarësisht kësaj, ajo është larguar padrejtësisht nga puna. Ndër të tjera, Znj. N. H. shprehet se ka një përvojë shumë vjeçare në punë dhe është vlerësuar gjithmonë maksimalisht nga punëdhënësi. Në këto kushte, ankuesja pretendon se është diskriminuar, nga Z. E. A., Drejtor i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për shkak të bindjeve të saj politike të djathta¹, si dhe për shkak të vendlindjes së saj, që është Dragobia².

Pretendimet e ankueses N. H. për diskriminim për shkaqet e mësipërme drejtohen edhe ndaj Znj. O. B., Drejtoreshë e Marrëdhënieve me Publikun, pranë FSDKSH-së. Sipas saj, qendrimi i Znj. O. B., ndaj saj, ka qenë tepër ofendues në disa raste. Për sa më sipër, ankuesja thekson faktin se i është drejtuar Znj. O. B. nëpërmjet e-mailit zyrtar, si dhe shkresërisht në datën 12.04.2018, ku ka evidentuar momentet, në të cilat ajo është ndier e fyer dhe e ofenduar nga qendrimet e saj.

Ndërkohë që, pretendimet e ankueses për diskriminim nga Znj. D. R., ish-Drejtoreshë e Drejtorisë Ekonomike pranë FSDKSH-së, e kanë filluesën në vitin 2013. Ankuesja thekson faktin se megjithëse kontaktet e saj me të kanë qenë të rralla, sjellja e e Znj. D. R., ka qenë jo korrekte me të. Ankuesja përmend një rast të ndodhur pas muajit qershor 2013, kur Znj. D. R. i është drejtuar ankueses me fjalët: “*Maloket e qelbura....do t’ju zhdukim nga faqja e dheut*”, apo edhe një rast tjetër kur në një festë të organizuar nga institucioni, pasi u kënduan e kërcyen të gjitha valet e këngët nga trevat e Shqipërisë, sapo u vendos vallja e Tropojës, Znj. D. R. është është shprehur: “*Nuk dua ti dëgjoj as këngët dhe as meloditë e makolëve*”. Këto reagime të Znj. D. R. janë konsideruar si tepër diskriminuese nga ana e Znj. N. H..

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Pas analizimit paraprak të ankesës së Znj. N. H., Komisioneri i dërgoi shkresën nr. 562, datë 27.04.2018³, ku i kërkohet informacion i mëtejshëm mbi ankesën në fjalë, si dhe fakte e prova, mbi të cilat ajo do të mbështeste pretendimet e saj. Njëkohësisht, iu kërkua edhe momenti i ndodhjes dhe konstatimit të diskriminimit, për secilin subjekt ndaj së cilit ishte drejtuar ankesa e saj.

- Znj. N. H. dërgoi përgjigje nëpërmjet e-mailit të datës 07.05.2018.

2. Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 54, datë 24.04.2018, e Znj. N. H., u konstatua se:

¹ Referuar Kartës së Anëtarësisë së Znj. N. H., lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, në datën 18.06.2014.

² Referuar kartës së identitetit të Znj. N. H..

³ Informacioni i kërkuar shkresërisht, iu kërkua edhe nëpërmjet e-mailit zyrtar të Komisionerit.

- Referuar informacionit të dërguar me e-mail nga ankuesja, rezulton se në lidhje me pretendimin për diskriminim, për shkak të “vendlindjes” dhe “bindjeve politike” të ankuseses, nga ana e Znj. D. R., rasti i parë i diskriminimit të pretenduar kishte ndodhur në muajin tetor 2014 dhe rasti i dytë në muajin dhjetor 2014. Ankuesja nuk ka dhënë informacion mbi momentin e konstatimit të diskriminimit, duke presupozuar faktin që konstatimi ka qenë i menjëhershëm.

Në nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 parashikohet se ankesa nuk pranohet, nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijani nga i dëmtuari, për këtë fakt. Referuar formularit të ankesës rezulton se diskriminimi i pretenduar nga ankuesja, për Znj. D. R., ka ndodhur në muajt tetor dhe dhjetor 2014, ndërkohë që ankesa e saj është depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në datën 24.04.2018, pra më shumë se një vit nga momenti i marrjes dijani për këtë fakt dhe gjithsesi më shumë se tre vite nga sjellja diskriminuese e pretenduar.

Për sa më sipër, Komisioneri vendosi mospranimin e asaj pjese të ankesës së Znj. N. H., që drejtohet kundër Znj. D. R., pasi është depozituar jashtë afatit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

3. Në vijim, pasi u konstatua se nga pikëpamja formale, pjesa tjetër e ankesës i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
 4. Nëpërmjet shkresës nr. 562/2 Prot., datë 15.05.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, njoftoi Z. E. A., Drejtues i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Znj. O. B., Drejtore e Marrëdhënieve me Publikun, mbi ankesën e mësipërme, si dhe kërkoi informacion mbi çështjet e parashtruara nga ankuesja, si dhe u kërkua në mënyrë të veçantë informacion mbi çështjet e mëposhtme:
 1. Numri i përgjithshëm i punonjësve të FSDKSH-së, të cilëve iu janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, si pasojë e ristrukturimit të institucionit dhe datat e emërimit të tyre në detyrë;
 2. Numri i punonjësve, që kanë të njëjtën vendlindje me ankuesen (ose vendlindja e tyre i përket zonës veriore të Shqipërisë) dhe janë ende në marrëdhënie pune me FSDKSH-në, edhe pas ristrukturimit të institucionit;
 3. Numri i punonjësve, që kanë të njëjtën vendlindje me ankuesen (ose vendlindja e tyre i përket zonës veriore të Shqipërisë) dhe u janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me FSDKSH-në, si pasojë e ristrukturimit të institucionit;
 4. Numri i punonjësve të emëruar në detyrë në vitin 2010, të cilët ndodhen ende në marrëdhënie pune me FSDKSH-në.
- Në përgjigje të shkresës nr. 562/2 Prot., datë 15.05.2018, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtori i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dërgoi shkresën nr. 562/3, datë 18.06.2018, nëpërmjet së cilës e bën me dije Komisionerin, se Fondi

e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr. 10 383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, (të ndryshuar) dhe të vendimit nr. 124, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar). Fondi është i vetmi person juridik, publik, autonom, i cili ofron dhe administron sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, si dhe ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet strukturave të tij organizative, që përbëhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Fondit dhe zyrat e tij, vendore.

Me Vendimin nr. 63, datë 25.09.2017, të Këshillit Administrativ, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të Punonjësve të FSDKSH-së”, struktura e Fondit është pakësuar me 163 punonjës. Rishikimi i strukturës ka ardhur si domosdoshmëri pas konstatimeve se struktura e FSDKSH-së kishte mbivendosje të pozicioneve të punës, pozicione pune që nuk e justifikonin ngarkesën dhe objektivat e vendosura. Objekt i këtij rishikimi ka qenë edhe drejtoria, ku ka punuar Znj. N. H.

Në mbështetje të Kodit të Punës është kryer zgjidhja e kontratës individuale të punës me ankuesen, duke zbatuar procedurat e parashikuara në nenin 92, 94, 143 dhe 145 të Kodit të Punës, ku janë respektuar afati i njoftimit prej 3 muajsh në respektim të kohëzgjatjes së punësimit, shpërblimi për vjetërsi me 3.5 paga mujore, shpërblimi për leje vjetore të pakryer, si dhe 20 ore në javë leje të pagueshme për të kërkuar një punë të re.

Në shkresën e sipërpërmendur theksohet fakti se, pretendimet e ankueses për diskriminim për shkak të bindjeve të saj politike të djathta, si dhe për shkak të vendlindjes së saj, drejtuar Znj. O. B. janë të pabazuara në fakte dhe prova.

Lidhur me çështjet, për të cilat, Komisioneri ka kërkuar informacion, FSDKSH e bën me dije si më poshtë vijon:

1. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të FSDKSH, të cilëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës, si pasojë e ristrukturimit është 8 (tetë). Datat e emërimit të tyre në detyrë janë: datë 29.01.2016, datë 07.03.2017, datë 07.03.2017, datë 07.03.2017, datë 07.03.2017, datë 31.05.2011, datë 07.04.2009, datë 07.07.2009 dhe datë 23.02.2011.
2. Numri i përgjithshëm i punonjësve që kanë të njëjtën vendlindje me ankuesen (ose vendlindja e tyre i përket veriut të Shqipërisë) dhe janë ende në marrëdhënie pune me FSDKSH-në, edhe pas ristrukturimit të institucionit, është 25 punonjës, përkatësisht 3 punonjës me vendlindje Tropojën, 4 punonjës me vendlindje Kukësin, 11 punonjës me vendlindje Dibrën, 4 punonjës me vendlindje Shkodrën, 1 punonjës me vendlindje Vaun e Dejës, 1 punonjës me vendlindje Lezhën dhe 1 punonjës me vendlindje Krujën.
3. Numri i punonjësve, që kanë të njëjtën vendlindje me ankuesen (ose vendlindja e tyre i përket zonës veriore të Shqipërisë) dhe u janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Drejtorinë e Përgjithshme të FSDKSH-së, si pasojë e ristrukturimit të institucionit është 2 (dy).

4. Numri i punonjësve të emëruar në detyrë në vitin 2010, si dhe përpara vitit 2010, të cilët ndodhen ende në marrëdhënie pune me Drejtorinë e Përgjithshme të FSDKSH-së janë rreth 58 punonjës.

Për sa më sipër, në shkresë theksohet fakti se në kriteret e përgjithshme dhe të posaçme, të vendosura për punësimin e punonjësve pranë FSDKSH-së, apo në dokumentacionin shoqëruar të tyre, nuk kërkohet karta e anëtarësisë në ndonjë parti apo forcë politike. Për këtë arsye, pretendimet e ankueses për diskriminim për shkak të bindjeve të saj të djathta, si dhe për shkak të vendlindjes së saj, janë të pabazuara në fakte dhe prova.

- Në vijim, Drejtuesi i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dërgoi shkresën nr. 2345/2, datë 12.07.2018, nëpërmjet së cilës përcjell informacion mbi ndryshimin e strukturës së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Në bazë të informacionit të dërguar rezulton se Sektori i Trajnimeve është suprimuar dhe është bashkuar me Sektorin e Burimeve Njerëzore, gjë që ka sjellë reduktimin e stafit dhe suprimimin e vendit të punës së Znj. N. H.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

- **Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesja:**

Referuar dokumentacionit të depozituar, në cilësinë e provës nga të dy palët në proces, rezulton se ankuesja është punësuar në vitin 2010, në pozicionin e Përgjegjës së Sektorit të Zbatimit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë⁴, të ISKSH (ish-Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor) aktualisht emërtuar si Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Në vijim, referuar kontratës individuale të punës nr. 307/1, datë 16.01.2014, me afat të pacaktuar, të lidhur ndërmjet ankueses dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Znj. N. H. ka kaluar në pozicionin e specialistes pranë Sektorit të Trajnimeve, pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në FSDKSH.

Për sa më sipër, rezulton se nëpërmjet Vendimit nr. 63, datë 25.09.2017, të Këshillit Administrativ të FSDKSH-së është vendosur pakësimi prej 163 punonjësve në numrin total të punonjësve të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ku përfshihen edhe Drejtoritë Rajonale të FSDKSH-së, nëpër rrethe. Në vijim të vendimit të sipërpërmendur, është miratuar Vendimi nr. 14, datë 02.02.2018, i Drejtorit të Përgjithshëm, të FSDKSH-së “Për miratimin e strukturës organizative, strukturës së brendshme dhe të rregullores për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e punës së Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit

⁴ Fillimisht, nëpërmjet Urdhërit nr. 57, datë 09.04.2010, të Drejtorit të Përgjithshëm, të ISKSH-së, ankuesja është emëruar provizorisht (me kontratë të përkohshme pune) në pozicionin e Përgjegjës së Sektorit të Zbatimit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë; Nëpërmjet Urdhërit nr. 75/2, datë 10.09.2010, të Drejtorit të Përgjithshëm të ISKSH-së, ankuesja është emëruar pas përfundimit të periudhës së provës, në të njëjtin pozicion pune dhe në vijim me anë të Urdhërit nr. 75/1, datë 01.06.2010, Znj. Nushe N. H. është shpallur fituese në vendin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Zbatimit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare, në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë”. Marrëdhëniet e punës janë rregulluar nëpërmjet kontratës individuale të punës nr. 302 Prot., datë 07.02.2012, me afat të pacaktuar, të lidhur ndërmjet palëve.

Shëndetësor”. Referuar shkresës nr. 2345/1, datë 13.06.2018, të FSDKSH-së rezulton se në Drejtorinë e Përgjithshme të FSDKSH-së janë suprimuar 8 vende pune, një ndër të cilët është edhe pozicioni Znj. N. H.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se procesi i ndryshimit struktural të këtij institucioni është një proces madhor që ka prekur këtë institucion në tërësinë e tij, duke suprimuar 163 vende pune dhe përkatësisht 8 pozicione pune, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të tij. Ky proces ristrukturimi nuk ka prekur vetëm pozicionin e punës së Znj. N. H., por 163 pozicione pune të ndryshme në nivel qendror dhe rajonal.

Në vijim të kryerjes së këtij ristrukturimi institucional, Komisioneri ka konstatuar se në mbështetje të Kodit të Punës është kryer zgjidhja e kontratës individuale të punës me ankuesen, duke zbatuar procedurat e parashikuara në nenin 92, 94, 143 dhe 145 të Kodit të Punës, ku janë respektuar afati i njoftimit prej 3 muajsh në respektim të kohëzgjatjes së punësimit, shpërblimi për vjetërsi me 3.5 paga mujore, shpërblimi për leje vjetore të pakryer, si dhe 20 ore në javë leje të pagueshme për të kërkuar një punë të re.

Për sa më sipër, në mënyrë të detajuar, procedura e ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me ankuesen është iniciuar nëpërmjet shkresës nr. 1391, datë 19.03.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH-së, ku ankuesja është njoftuar për takim pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe ku është diskutuar në lidhje me vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës. Në vijim, nëpërmjet shkresës nr. 1391/2, datë 03.04.2018, ankuesja është njoftuar për ndërprerje të marrëdhënieve të punës. Me Urdhërin nr. 111, datë 03.04.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm, Znj. N. H. i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për shkak të ristrukturimit të institucionit. Referuar Urdhërit të sipërpërmendur, është përcaktuar se në zbatim të nenit 143, pika 1 të Kodit të Punës, Znj. N. H. i ndërpriten marrëdhëniet e punës, pas një periudhe 3 mujore, përkatësisht në datën 23.06.2018. Gjatë kësaj periudhe, ajo ka përfituar 20 orë leje të pagueshme në javë për të kërkuar punë të re, sipas parashikimit të nenit 143, pika 5, të Kodit të Punës. Njëkohësisht, në zbatim të nenit 145 të Kodit të Punës ajo ka përfituar shpërblim për vjetërsi në masën 3.5 paga, si dhe në zbatim të neneve 92 dhe 94 të Kodit të Punës, Znj. N. H. ka përfituar 14 ditë leje vjetore. Në këtë kontekst, Komisioneri nuk konstaton qëndrim të padrejtë të mbajtur ndaj ankueses nga ana e titullarit të FSDKSH-së.

Referuar informacionit të përcjellë nga FSDKSH, lidhur me strukturën aktuale dhe të mëparshme të institucionit, rezulton se Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka pësuar ndryshime. Sektori i Trajnimeve është suprimuar dhe është bashkuar me Sektorin e Burimeve Njerëzore, gjë që ka sjellë reduktimin e stafit dhe suprimimin e vendit të punës së Znj. N. H. Vendi i punës është suprimuar për të dy specialistet në Sektorin e Trajnimeve. Pra, përveç pozicionit të Znj. N. H., edhe pozicioni i punës së specialistes tjetër të këtij sektori, përkatësisht Znj. S.M, është suprimuar. Edhe në këtë aspekt, Komisioneri konstaton se Znj. N. H., në kuptim të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nuk është ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë nga ana e FSDKSH-së, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme me të.

Në kuadër të shqyrtimit të kësaj ankese, vlen të theksohet fakti se nga informacioni i dërguar nga FSDKSH, rezulton se pranë këtij institucioni vazhdojnë të punojnë ende punonjës, të cilët kanë si vendlindje Tropojën apo që kanë si vendlindje te tyre, qytete ne veri të Shqipërisë. Kështu rezulton se numri i përgjithshëm i punonjësve, që kanë të njëjtën vendlindje me ankuesen (ose vendlindja e tyre i përket veriut të Shqipërisë) dhe janë ende në marrëdhënie pune me FSDKSH-në, edhe pas ristrukturimit të institucionit, është 25 punonjës, përkatësisht 3 punonjës me vendlindje Tropojën, 4 punonjës me vendlindje Kukësin, 11 punonjës me vendlindje Dibërën, 4 punonjës me vendlindje Shkodrën, 1 punonjës me vendlindje Vaun e Dejës, 1 punonjës me vendlindje Lezhën dhe 1 punonjës me vendlindje Krujën.

Njëkohësisht, rezulton se pranë FSDKSH-së, punojnë ende punonjës, të cilët janë emëruar gjatë periudhës kohore, kur në pushtet ka qenë forca politike Partia Demoratikë e Shqipërisë. Në bazë të informacionit të administruar, rezulton se numri i punonjësve të emëruar në detyrë në vitin 2010, si dhe përpara vitit 2010, të cilët ndodhen ende në marrëdhënie pune me Drejtorinë e Përgjithshme të FSDKSH-së janë rreth 58 punonjës.

Për sa më sipër, Komisioneri nuk ka tagër të gjykojë mbi nevojat apo procesin e ritrukturimit të një institucioni si FSDKSH, por mbështetur në atributet që i jep ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mund të kryejë konstatim, nëse ankuesja i është nënshtruar apo është ekspozuar një qëndrimi të padrejtë, disfavorizues apo të pabarabartë, nga ana e titullarit të FSDKSH, në krahasim me punonjës të tjerë që ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, në kuptim të nenit 7, pika 1 të këtij ligji.

Mbështetur në analizimin e fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri gjykon se nuk ndodhemi në kushtet e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe disfavorizues të ankueses, në krahasim me individë të tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme, me të, nga ana e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Për sa më sipër, në mungesë të trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe disfavorizues të ankueses nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për shkaqet e pretenduara nga Znj. N. H., nga ana e Drejtuesit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Lidhur me pretendimin e Znj. N. H. për diskriminim të saj, për shkaqet e mësipërme, nga ana e Znj. O. B., Drejtoreshë e Marrëdhënieve me Publikun, pranë FSDKSH-së, ku theksohet fakti se qëndrimi i Znj. O. B., ndaj saj, ka qenë tepër ofendues, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk e ka provuar me fakte dhe prova konkrete, që sjellje të tilla ofenduese kanë ndodhur. Ankuesja përmend faktin se i është drejtuar Znj. O. B. nëpërmjet e-mailit zyrtar, si dhe shkresërisht në datën 12.04.2018, ku ka evidentuar momentet, në të cilat ajo është ndier e fyer dhe e ofenduar nga qëndrimet e saj, por Komisioneri nuk disponon asnjë përgjigje të Znj. O. B. ndaj Znj. N. H., ku të reflektohet reagimi diskriminues ndaj saj, apo të vërtetohet fakti se sjellje të tilla diskriminuese kanë ndodhur vërtet.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 9, pikat 1-2, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 12 e 13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 4, gërma dh) e pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “*vendlindjes*” dhe “*bindjeve politike*”, të Znj. N. H., nga ana e Drejtorit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “*vendlindjes*” dhe “*bindjeve politike*”, të Znj. N. H., nga ana e Znj. O. B., Drejtoreshë e Marrëdhënieve me Publikun, pranë FSDKSH-së.
3. Mospranimin e ankesës së Znj. N. H., ndaj Znj. D. R., ish-Drejtoreshë e Drejtorisë Ekonomike pranë FSDKSH-së, pasi kjo ankesë është depozituar jashtë afatit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 45 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(Shkak : bindja politike, vendlindja
Fusha: punësim)